



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.333/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se me datë 21.10.2017, kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Edita Potera, nga radhët e subjektit politik AAK, ka bërë fushatë duke shpërndarë fotografi në facebook, me logo dhe numër të AAK-së dhe numër të saj për anëtare të Kuvendit Komunal. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik AAK ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 36 par. 1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se nga provat e administruara në këtë rast nuk janë vërtetuar pretendimet ankimore se kandidatja në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017, pasi që nga fotografia e shpërndar në rrjetin social facebook,

nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së postimit të bërë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit të Komunës së Ferizajt nga radhët e subjektit politik AAK.

Andaj në mungesë dëshmime të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 të LZP-së paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.333/2017 më datën 22.10.2017

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.